



Njoftimi i përqendrimit në mes të Çimentores USJE SHA Shkup dhe Shoqërisë
Aksionare ID Kompani SHPKNJP import-eksport Koçan

(lënda nr. 08-42/2016)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11 dhe 41/14), me datën 22.08.2016, plotësuar me datë 19.05.2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës merr njoftimin e përqendrimit me të cillin Çimentorja USJE SHA Shkup, me seli në rr. „Boris Trajkovski” nr. 94, 1000 Shkup, ka për qëllim të fiton kontrollin e vetëm të drejtpërdrejt ndaj Shoqërisë Aksionare ID Kompani SHPKNJP import-eksport Koçan, me seli në rr. „Edvard Kardel” nr. 18, Koçan.

1. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Çimentorja USJE SHA Shkup është aktive kryesisht në prodhimin dhe tregtimin e çimentos, mjetë lidhëse hidraulike usjemall, beton, klinker, agregat, dhe materiale tjera të ndërtimit.

Shoqëria Aksionare ID Kompani SHPKNJP import-eksport Koçan- merret me prodhimin e produkteve të mullirit.

Parashtruesi i njoftimit thekson se si tregu relevant i produkteve duhet të definohet në treg në materiale alternative të çimentos (aditivë të çimentos).

1. Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni konstaton se përqendrimi në shqyrtim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.
2. Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

31.08.2016
Shkup